



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 15.1.2025

Nr: 1

Ora: 11:00

VENDIMI

PËR

PRANIMIN PËR SHOYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 14, DATË 24.10.2024 TË DEPOZITUAR NGA TV KOPLIKU

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.1.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi kryesisht çështjen me:

ANKUES: TV Kopliku

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

BAZË LIGJORE: Nenet 12/5, 7, neni 21, pika 1 shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 15.1.2025 Nr: 1
Ora: 11:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 14 datë 24.10.2024 të depozituar nga TV Kopliku”

VËREN:

1. Subjekti TV Kopliku depozitoi pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, u regjistrua në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 14 regj., datë 24.10.2024.
2. Në mbledhjen e datës 15.1.2025, pas relativitetit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 14, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 14, datë 24.10.2024 të depozituar subjekti nga TV Kopliku.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet në seancën e datës 15.1.2025, ora 11:30.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar